



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.334/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret : Bujar Muzaqi kryesues, Ramush Bardiqi dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesat e Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje me seli në Komuna Prishtinë (LVV), të parashtruara kundër Subjektit Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHEN SI TË BAZUARA, ankesat e Subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, Anr.334/2025, Anr.335/2025, Anr.336/2025 dhe Anr.339/2025 të datës 03.02.2025.

II. Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 16.000.00 € (Gjashtëmbëdhjetë mijë) euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 03.02.2025, PZAP-i ka pranuar ankesat nga Subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.334/2025, Anr.335/2025, Anr.336/2025 dhe Anr.339/2025 datë 03.02.2024.

-Në ankesë Anr.334/2025 pretendohet se me 2 shkurt 2025, mbështetësi i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës - PDK, Agim Spahiu, ka postuar në Llogarinë e tij në rrjetin social Facebook fotografi me tekst i cili përmban gjuhë urrejtëse dhe ofenduese si dhe bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë. Teksti i plotë dhe origjinal në llogarinë personale të Agim Spahiu në rrjetin social

Facebook, është si në vijim: "Apo shkoni ej ? Hajde ma gjalle m gjalle Trullqa...!", "Fare e Keqe phuuuu".

PROVË: Postimi në rrjetin social.

- Në ankesën 335/2025, pretendohet se me 2 Shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE kanë identifikuar mbështetësin e PDK-së Mentor Gecaj i cili në kuadër të postimeve të shumta të tij ofenduese dhe nxitëse për urrejtje kundrejt LVV-së, në llogarinë e tij në facebook poashtu ka shpërndarë fotografinë me fjalët " VV ANTI KOMBE PROSERB, "Hajrije Spikerica", "Kjo eshte VV Analfabeta funksional", duke nxitur urrejtje dhe duke fyer e ofenduar mes tjerash.

-Në ankesën 336/2025, pretendohet se me 2 Shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE kanë identifikuar mbështetësin e PDK-së Nexhmi Muçiqi i cili në kuadër të postimeve të shumta të tij ofenduese dhe nxitëse për urrejtje kundrejt LVV-së, në llogarinë e tij në facebook poashtu ka shpërndarë fotografinë me fjalët " VV ANTI KOMBE PROSERB, "Hajrije Spikerica", "Kjo eshte VV Analfabeta funksional", duke nxitur urrejtje dhe duke fyer e ofenduar mes tjerash.

- Në ankesën 339/2025, pretendohet se me 2 Shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE kanë identifikuar mbështetësin e PDK-së Blend Zymi i cili në kuadër të postimeve të shumta të tij ofenduese dhe nxitëse për urrejtje kundrejt LVV-së, në llogarinë e tij në facebook poashtu ka shpërndarë fotografinë me fjalët " Qe dëshmia se thojsha nuk ka luftu Xhelal Cfeklla", duke nxitur urrejtje dhe duke fyer e ofenduar mes tjerash.

Përmes këtij veprimi mbështetësit/ simpatizantët e partisë politike PDK, dhe subjekti politik PDK kanë shkelur dispozitat e nenit 34. paragrafi 1, pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.

Më tej në ankesa thuhet se aktivistët e Qendrës së Vetëvendosjes kanë vërejtur se mbështetësi, përkrahësi i Partisë Demokratike të Kosovës z. Blend Zymi, Nexhmi Muçiqi, Mentor Gecaj, dhe Agim Spahiu përmes llogarisë personale në rrjetin social Facebook për qëllime politike vazhdimisht kanë shpërndarë materiale propagandistike, shpifëse dhe fyese ndaj Kryeministrit Kurti, kandidatëve për deputet dhe anëtarëve tjetër të Lëvizjes Vetëvendosje.

Me këto veprime sipas parashtruesit te ankesave është bërë shkelje e rëndë e Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, respektivisht nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11.

Si provë që dëshmon shkeljen e pretenduar kanë bashkangjitur fotografi nga postimet në rrjetin social facebook.

Provë linku <https://www.facebook.com/spahiu.agim>

<https://www.facebook.com/profile.php?id=61550085053006>

Foto në mbështetje të kandidatit të PDK-së,

Foto montazh të profilit të kandidatve të LVV.

Foto monazh të kandidatve të LVV-së.

Facebook.com <https://www.facebook.com/blend.zymi>.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga subjekti politik PDK, thekson se fillimisht duhet të shqyrtohet çështja e afatshmërisë së ankesës, pasi që siç mund të vërehet, ankuesi nuk i ka bashkëngjitur si dëshmi asnjë provë me të cilën argumentohet koha në të cilën ka ndodhur shkelja e pretenduar, pasi që në vështrim të provës së bashkëngjitur, dëshmohet vetëm që postimi të jetë shpërndara para disa orësh, mirëpo nuk mund të vërtetohet koha se kur është bërë Screenshoot, andaj si i tillë është e pamundur që të vërtetohet se në cilën kohë ka ndodhur shkelja e pretenduar në ankesë.

Më tej theksohet se PDK, ka bërë kërkim në rrjetin social Facebook të profileve të personave të lartpërmendur, në të cilët profile, vërehet se të njëjtit shpërndajnë postime të ndryshme në rrjetin e tyre social, e të cilat padyshim i bëjnë nën petkun personal dhe jo atë partiak, rrjedhimisht të njëjtit në profilet e tyre nuk kanë të postuar fare ndonjë fotografi bindëse për të dëshmuar që këto profile janë origjinale, e lëre më të dëshmohet fakti se të njëjtit kanë ndërlidhje me subjektin politik PDK.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik PDK, konsideron se në mungesë të argumentimit të përgjegjësive subjektive të PDK, nga ana e ankuesit, është e pamundur që PDK të argumentoj që të njëjtit nuk janë mbështetës apo votues i PDK-së, mirëpo PDK garanton se personat të cilat janë Objekt i kësaj ankesë, NUK JANË PJESË E STRUKTURAVE PARTIAKE DHE NUK PËRFAQËSOJNË SUBJEKTIN TONË POLITIK,

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat Anr.334/2025, Anr.335/2025, Anr.336/2025 dhe Anr.339/2025 të parashtruara me datë 03.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.334/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti politik LVV, kundër subjektit të njëjtë politik PDK, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura nga ankesat.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, konstatoi se:

-Ankesat janë të bazuara.

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruar si provë materiale, konstatoi se postimi dhe përdorimi i kësaj gjuhe nga simpatizantët e subjektit politik të PDK-së, Agim Spahiu, Mentor Gecaj, Nexhmi Muçiqi dhe Blend Zymi, në kuadër të fushatës zgjedhore, konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore ka për qëllim të krijojë një lidhje negative ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe krijoj atmosferë tensioni dhe përçarjeje. Veprimet i tilla interpretohen si një përpjekje për të manipuluar perceptimin e votuesve, duke krijuar një lidhje negative mes një partie politike dhe një figure politike të përfolur. Kjo mund të shihet si një mënyrë për të përdorur figura të njohura për të stigmatizuar një subjekt politik dhe për të rritur ndjenjat negative kundrejt tij. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët dhe simpatizantët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike. Përdorimi i figurave të tilla të përfolura mund të dëmtojë

procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Përdorimi i një gjuhe të tillë, sipas vlerësimit të Panelit është në kundërshtim me nenit 34 paragrafi 1 pika l.11), e LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Me nenin 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, është përcaktuar se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet *“të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000 €) Euro.”*

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje, dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë, që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Andaj Paneli vëren se gjuha, dhe fotografitë e përdorura janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet të ngjashme si dhe faktin që subjekti politikë në fjalë ka bërë shkelje të natyrës së njëjtë e për të cilat shkelje paneli ka shqiptuar dënime me gjobë.

Paneli ka vlerësuar edhe pretendimet nga përgjigja në ankesë, mirëpo të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, për faktin se subjekti politik PDK të njëjtat pretendime nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

A.nr.334/2025 datë 05.02.2025



**Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimet të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.43/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Rustem Thaqi dhe Lumni Sallauka, anëtarë të kolegjit duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 09.02. 2025, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.334/2025, të datës 05.02.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 11.02.2025 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **Pranohet** si pjesërisht e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë dhe ndryshohet pjesërisht vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.334/2025, i datës 05.02.2025, ashtu që **refuzohen** si të pa bazuar ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.334/2025, e datës 02.02.2025 dhe ankesa A.nr.339/2025 e datës 02.02.2025 dhe subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, **i shqiptohet** dënimi më gjobë në lartësi prej 8,000.00€.
- II. **Refuzohet** si pjesërisht e pa bazuar, ankesa e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dhe vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.334/2025, i datës 02.02.2025, në pjesën tjetër **vërtetohet**.



Arsyetim

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.334/2025, të datë 02.02.2025, ishte vendosur "I. Pranohen si të bazuara, ankesat e Subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, Anr.334/2025, Anr.335/2025, Anr.336/2025 dhe Anr.339/2025 të datës 03.02.2025. II. Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 16.000.00 € (Gjashtëmbëdhjetë mijë) Euro. III. Detyrohet Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.


Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, (PDK), me kohë ka paraqitur ankesë për shkak që siç thuhet në ankesë, "konstatimit te gabuar te gjendjes faktike dhe për faktin se "Vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së dhe vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike;, duke i propozuar Gjykatës Supreme që Gjykatës Supreme të Kosovës, i propozojmë që të : I. Aprovohet ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, si e bazuar; II. Anulohet vendimin A.nr.334/2025, i datës 03 shkurt 2025, i nxjerrë nga PZAP;III. Refuzohen si të pabazuara ankesat A.nr.334/2025, A.nr.335/2025, A.nr.336/2025

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e Subjektit Politik të dënuar me këtë vendim, të refuzohet si e pabazuar ndërsa të vërtetohet vendimi A.nr.224/2025, të datë 30.01.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës është pjesërisht e pabazuar.

Më datë 03.02.2025, PZAP-i kishte pranuar ankesat nga Subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.334/2025, Anr.335/2025, Anr.336/2025 dhe Anr.339/2025 datë 03.02.2024. Në ankesë Anr.334/2025 pretendohet se me 2 shkurt 2025, mbështetësi i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës - PDK, Agim Spahiu, ka postuar në Llogarinë e tij në rrjetin social Facebook "A po shkoni ej? Hajde ma gjallë trullqja Farë e Keqe



phuuuu". PROVË: Postimi në rrjetin social. Në ankesën 335/2025, pretendohet se me 2 Shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE kanë identifikuar mbështetësin e PDK-së Mentor Gecaj i cili në kuadër të postimeve të shumta të tij ofenduese dhe nxitëse për urrejtje kundrejt LVV-së, në llogarinë e tij në facebook po ashtu ka shpërndarë fotografinë me fjalët "VV ANTI KOMBE PROSERB, "Hajrije Spikerica", "Kjo është VV Analfabeta funksional", duke nxitur urrejtje dhe duke fyer e ofenduar mes tjerash. Në ankesën 336/2025, pretendohet se me 2 Shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE kanë identifikuar mbështetësin e PDK-së Nexhmi Muçiqi i cili në kuadër të postimeve të shumta të tij ofenduese dhe nxitëse për urrejtje kundrejt LVV-së, në llogarinë e tij në facebook poashtu ka shpërndarë fotografinë me fjalët "VV ANTI KOMBE PROSERB "Hajrije Spikerica", "Kjo është VV Analfabeta funksional", duke nxitur urrejtje dhe duke fyer e ofenduar mes tjerash me postime tjera. Në ankesën 339/2025, pretendohet se me 2 Shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE kanë identifikuar mbështetësin e PDK-së Blend Zymi i cili në kuadër të postimeve të shumta të tij ofenduese dhe nxitëse për urrejtje kundrejt LVV-së, në llogarinë e tij në facebook po ashtu ka shpërndarë fotografinë me fjalët "Qe dëshmia se thojsha nuk ka luftu Xhelal Cfeklla", duke nxitur urrejtje dhe duke fyer e ofenduar mes tjerash.

Më tej në ankesa thuhet se aktivistët e Qendrës së Vetëvendosjes kanë vërejtur se mbështetësi, përkrahësi i Partisë Demokratike të Kosovës z. Blend Zymi, Nexhmi Muçiqi, Mentor Gecaj, dhe Agim Spahiu përmes llogarisë personale në rrjetin social Facebook për qëllime politike vazhdimisht kanë shpërndarë materiale propagandistike, shpifëse dhe fyese ndaj Kryeministrit Kurti, kandidatëve për deputet dhe anëtarëve tjetër të Lëvizjes Vetëvendosje.

Me këto veprime sipas parashtruesit të ankesave është bërë shkelje e rëndë e Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, respektivisht nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11. Si provë që dëshmon shkeljen e pretenduar kanë bashkëngjitur fotografi nga postimet në rrjete sociale duke i paraqitur linkat e këtyre publikimeve

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga subjekti politik PDK, thekson se fillimisht duhet të shqyrtohet çështja e afatshmërisë së ankesës, pasi që siç mund të vërehet, ankuesi nuk i ka bashkëngjitur si dëshmi asnjë provë me të cilën argumentohet koha në të cilën ka ndodhur shkelja e pretenduar, pasi që në vështrim të provës së bashkëngjitur, dëshmohet vetëm që postimi të jetë shpërndarë para disa orësh, mirëpo nuk mund të vërtetohet koha se kur është bërë Screenshot, andaj si i tillë është e pamundur që të vërtetohet se në cilën kohë ka ndodhur




shkelja e pretenduar në ankesë. Më tej theksohet se PDK, ka bërë kërkim në rrjetin social Facebook të profileve të personave të lartpërmendur, në të cilët profile, vërehet se të njëjtit shpërndajnë postime të ndryshme në mjetin e tyre social, e të cilat padyshim i bëjnë nën petkun personal dhe jo atë partiak, rrjedhimisht të njëjtit në profilet e tyre nuk kanë të postuar fare ndonjë fotografi bindëse për të dëshmuar që këto profile janë origjinale, e lëre më të dëshmohet fakti se të njëjtit kanë ndërlidhje me subjektin politik PDK.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.0S/L-03 1, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat Anr.334/2025, Anr.335/2025, Anr.336/2025 dhe Anr.339/2025 të parashtruara me datë 03.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjen e përbashkët A.nr.334/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti politik LVV, kundër subjektit të njëjtë politik PDK, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura nga ankesat.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, konstatoi se Ankesat janë të bazuara. Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruar si provë materiale, konstatoi se postimi dhe përdorimi i kësaj gjuhe nga simpatizantët e subjektit politik të PDK-së, Agim Spahiu, Mentor Gecaj, Nexhmi Muçiqi dhe Blend Zymi, në kuadër të fushatës zgjedhore, konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marr në kohë të fushatës zgjedhore ka për qëllim të krijojë një lidhje negative ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe krijoj atmosferë tensioni dhe përçarjeje. Veprimet i tilla interpretohen si një përpjekje për të manipuluar perceptimin e votuesve, duke krijuar një lidhje negative mes një partie politike dhe një figure politike të përfolur. Kjo mund të shihet si një mënyrë për të përdorur figura të njohura për të stigmatizuar një subjekt politik dhe për të rritur ndjenjat negative kundrejt tij. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët dhe simpatizantët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike. Përdorimi i figurave të tilla të përfolura mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Përdorimi i një gjuhe të tillë, sipas vlerësimit të Panelit është në kundërshtim me nenit 34 paragrafi pika 1.11), e LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërit si në vijim:




përdorini i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në vendimin e PZAP, përveç në pjesën aprovuese të ankesës ku vendimi është ndryshuar, pasi që vendimi i kundërshtuara nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës dhe as në zbatim të gabuar të se drejtës material, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, të marrë sipas vendimit të ankimuar, lidhur me dënimin me gjobë të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), pasi që vendimi i kundërshtuar është në përputhje me gjendjen faktike të konstatuara dhe dispozita ligjore që i referohen shkeljeve nga ana e subjekteve e politike.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, përcaktuese për ligjshmërinë e gjobës së shqiptuara nga PZAP, janë rrethanat e provuara të deklarimeve të eksponentëve të parashtruesit të ankesës sidomos në ankesën A.nr. 335/2025 të datës 02.02.2025, ku eksponenti i parashtruesit të ankesës Mentor Gecaj ka shpërndarë fotografinë me fjalët "VV ANTI KOMBE PROSERB, "Hajrije Spikerica", "Kjo është VV Analfabeta funksional" ndërsa në ankesën A.nr.336/2025 të datës 02.02.2025 Blend Zymi ka shpërndarë të njëjtën përmbajtje duke e shoqëruar me komente dhe postime tjera me çka dëshmohet se këta eksponent kanë përdor gjuhë që cenon standardin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike ndaj një kandidati të një subjekti tjetër politik dhe në këtë mënyrë ka cenuar Kodin e Mirësjelljes dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Në këtë mënyrë kandidatët apo eksponentët në fjalë, kanë cenuar Kodin e Mirësjelljes dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Në këtë kontekst Gjykata Supreme e pranon në tërësi arsyetimin e dhënë nga PZAP, lidhur me faktet e konstatuar, provat e administruara, vlerësimin për faktet thelbësore, vlerësimin për provuat dhe mënyrë se si është kualifikuara shkelje e konsumuar. Në logjikën e njëjtë është pranuar edhe vlerësimi për lartësinë e gjobës së shqiptuar sepse për një vendim të tillë PZAP, ka dhen arsye për secilën rrethanë të vlerësuara dhe për mënyrë se si në tërësi gjendja e konstatuar është kualifikuar si shkelje e sanksionuara në këtë rast me sanksion gjobën e shqiptuar për shkak se sipas Gjykatës Supreme të Kosovës, në pjesën refuzuese të ankesës ndaj vendimit të PZAP-



së, gjuha e përdorur nga subjekti PDK siç është dokumentuar në ankesat tjera, është e pa përshtatshme dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe se ky subjekt ka konsumuar në tërësi shkeljet nga nenin 118 pika 4 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë dhe se gjoha e shqiptuar është në përputhje me peshën e shkeljes. Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj, pretendimet në ankesë lidhur shkeljen e Kodit dhe me gjobën e shqiptuar u refuzuan si të pa bazuara sepse si të tilla nuk dëshmuuan se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakteve të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Ndërsa për sa i përket pjesës ndryshuese të vendimit të PZAP-së, Gjykata Supreme gjeti se tek ankesat A.nr.334/2025 dhe tek ankesa A.nr.339/2025 nuk është konsumuar shkelja, sepse gjuha e përdorur në rrjetin social Facebook në rastin e parë me publikimin "A po shkoni ej? Hajde ma gjallë trullqa Farë e Keqe phuuuu" nuk i drejtohet personalisht askujt dhe se gjuha e përdorur nuk nënkupton që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, dhe për këtë arsye vendimi i PZAP-së, në këtë pjesë u deshtë që të ndryshohet. Për më tepër gjykata gjeti se linku që i referohet kësaj shkelje në profilin e të përmendurit nuk përmban asnjë publikim aktualisht. E njëjta është konstatuar edhe në ankesën A.nr. 339/2025 ku Blend Zymi me tekstin "Qe dëshmia se thojsha nuk ka luftu Xhelal Cfeklla", paraqitja e dilemës se a ka qenë individi pjesëmarrës në luftë apo jo, nuk nënkupton që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve.

Rrjedhimisht edhe për sa i përket lartësisë së gjobës, kjo gjykatë konsideron se me rastin e shqiptimit të gjobës së lartpërmendur, janë marr parasysh një mori rrethanash të theksuar si në arsyetimin e vendimit të ankimuar, lartësia e gjobës e paraparë për një shkelje të tillë sipas nenit 120 paragrafi 1 pika 1.3, të Ligjit 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, është deri në 50.000 €, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjoha e shqiptuar ndaj këtij subjekti politik në lartësi prej 8.000,00 €, është e drejtë dhe e ligjshme, me të cilin sigurisht do të arrihet qëllimi ligjor i tij, jo vetëm ndëshkimi i shkelësve të dispozitave të Kodit të Mirësjelljes të Subjektit politik, Mbështetësve dhe Kandidatëve të tyre, por edhe korrektimi i shkeljeve të ndryshme zgjedhore.



Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme pretendimet e Subjektit Politik për formën dhe përmbajtjen e vendimit janë të pa bazuara për faktin se, vendimi i kontestuar në pjesën aprovuese është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, e cila konstatoi se në rastin konkret edhe e drejta materiale, po ashtu është zbatuar drejt.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 120.1.3 dhe 34.1 (11), të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

AA.nr.43/2025, datë 11.02.2025

Kryetar i kolegjit

Beshir Islami



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik




GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-43/2025

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

PZAP - PRISHTINE

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebne precrtafi)

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi I sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqit, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u odredjeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domacin. Primaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domacinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribijeno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dana _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijema _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKT GJYKIM

11.02.2025

Numri i shtojcave: _____
broj priloga _____ 2

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrdjemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

Agashi 11.02.20

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili lica koje je
pismeno primilo u zamenu)

ORA

16:28

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shkruar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismenilij ište u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.